



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 874/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.11.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Murati” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-50272-09-20-2016 me objekt: *“Ndërtimi i catisë të godinës së maternitetit, rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare dhe disa ndërhyrje në Spitalin Kukës”, me fond limit 6,583,333 lekë pa tvsh e zhvilluar në datën 10.10.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.*

Ankimues:

“Sark” sh.p.k
Lagjia “8 Shkurti” , Blv “Skënderbej” Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Public Health II Sector

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 20.09.2016 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-50272-09-20-2016 me objekt: “Ndërtimi i catisë të godinës së maternitetit, rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare dhe disa ndërhyrje në Spitalin Kukës”, me fond limit 6,583,333 lekë pa tvsh e zhvilluar në datën 10.10.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

II.2. Në datën 10.10.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 21.10.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Vllaznimi	0.00	I skualifikuar
Kadia	0.00	I skualifikuar
Marsi/K	0.00	I skualifikuar
Meni	0.00	I skualifikuar
Nika	0.00	I skualifikuar

Murati	4,270,064.00	I kualifikuar
Sark	4,561,170.00	I kualifikuar
Denolt	4,617,687.00	I kualifikuar
Shamo-Construction	4,655,181.00	I kualifikuar
Delia Impex	4,723,720.00	I kualifikuar
Avduli	4,855,063.00	I kualifikuar
Kevin Konstruksion	5,503,261.42	I kualifikuar
Radika	4,564,510.00	I kualifikuar
Boshnjaku B	6,119,045.00	I kualifikuar

II.4. Në datën 27.10.2016 , operatori ekonomik ankimues “Sark” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Murati” sh.p.k, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

- *Renditja e klasifikimit nga KVO është i padrejtë sepse Sark sh.p.k ka gjithë dokumentacionin e nevojshëm për tu shpallur fitues i këtij prokurimi publik sikurse disponojmë informacione se kompania e shpallur fituese ka mangësi dhe paregullsi në dokumentacionin e vet kështu që KVO duhet të rishqyrtojë edhe një herë të gjithë dokumentacionin e kësaj kompanie sidomos në zërin kontratat e ngjashme që i ka mbaruar afati.*
- *KVO të shpallë fitues të këtij prokurimi Sark sh.p.k si ofertuesi më i mirë i paraqitur.*

II.5. Në datën 28.10.2016, me shkresën nr. 617 prot, operatori ekonomik ankimues “Sark” sh.p.k, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 03.11.2016, pala ankimuese “Sark” sh.p.k ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr.634 prot datë 08.11.2016 protokolluar me tonën me nr.2250/2 datë 10.11.2016 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sark” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Murati” sh.p.k me argumentin se “*nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Per sa i perket aftesise teknike e profesionale Operatori Ekonomik duhet te permbushë kerkesat e meposhtme minimale :

2.3.1

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit

ose

b) Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit është sa dyfishi i vlerës limit të kontratës, që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Per kontratat për punë publike te realizuara me subjekte shtetere, AK kërkon:

- *Kontratën/at e Sipërmarrjes*
- *Situacion Përfundimtar të objektit*
- *Formular vleresimi nga investitori sipas shtojces nr.7*
- *Akt Kolaudimi*
- *Faturat Tatimore për cdo situacion ku të shprehen qartë datat, vlera,koha dhe natyra e punës së bërë.*

Per kontratat për punë publike realizuar me subjekte private AK kërkon

- *Kontratën/at e Sipërmarrjes*
- *Situacion Përfundimtar të objektit*
- *Faturat Tatimore për cdo situacion*
- *Akt Kolaudimi*
- *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.7*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Murati” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë datë 16.06.2011 ndërmjet Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës dhe “Murati” sh.p.k me objekt “Rikonstruksion Muzeu Arkeologjik Durrës” me vlerë 85,498,425 lekë pa tvsh me afat 240 ditë.
- Aneks Kontratë Preventiv Punimesh “Rikonstruksion Muzeu Arkeologjik Durrës”.
- Formulari i Kontratës Nr.217 prot datë 16.06.2011
- Procesverbal Kolaudimi për objektin “Rikonstruksion Muzeu Arkeologjik Durrës” Periudha e Punimeve datë 16.06.2011-30.09.2013, Vlera e Situacionit Përfundimtar 102,598,110 lekë me tvsh.
- Situacion Përfundimtar në vlerën 7,564,143 lekë pa tvsh
- Certifikatë e marrjes në dorëzim përfundimtar të objektit “Rikonstruksion Muzeu Arkeologjik Durrës” datë 29.02.2016.
- Certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve më datë 18.02.2014.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës për subjektin Murati sh.p.k për objektin e kontratës ‘Rikonstruksion Muzeu Arkeologjik Durrës’

Data e fillimit të kontratës 16.06.2011-Data e mbarimit 30.09.2013 me vlerë 102,598,110 me tvsh e përmbushur.

- Vërtetim Realizimi Nr.354 Prot datë 04.03.2016 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës.
- Faturë Tatimore Shitje Nr.43 datë 08.08.2011 me vlerë 8,271,050 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr. 39 datë ___ me vlerë 8,609,780 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr. ___ datë ___ me vlerë 7,916,580 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr. ___ datë ___ me vlerë 604,167 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr. ___ datë ___ me vlerë 8,996,433 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.4 datë 31.10.2011 me vlerë 8,639,700 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.9 datë 12.12.2011 me vlerë 8,088,250 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.19 datë 23.04.2012 me vlerë 8,813,580 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.28 datë 29.06.2012 me vlerë 4,697,480 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.33 datë 06.07.2012 me vlerë 2,722,452 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.6 datë 05.04.2013 me vlerë 3,360,500 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.62 datë 05.08.2013 me vlerë 8,475,000 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.67 datë 01.10.2013 me vlerë 6,303,452 lekë pa tvsh

III.1.3. Në nenin 26 “Kontratat e Punëve Publike”, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.”

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Nga verifikimi i dokumentacionit sa më sipër, Komisioni konstaton se kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes ka datë fillimi dhe përfundimi një periudhë më të hershme se periudha tre vjeçare, gjatë së cilës kërkohet të vërtetohet se operatori ekonomik ka kryer punime të ngjashme. Përkatësisht referuar “Formularit të Vlerësimit” si dhe “Procesverbalit të Kolaudimit” të lëshuar për këtë kontratë, punimet për të kanë nisur në 16.06.2011 dhe kanë përfunduar në 30.09.2013 ndërkohë që KPP konstaton se procedura e prokurimit objekt ankimi referuar sistemit të prokurimeve elektronike është zhvilluar në datën 10.10.2016.

KPP sqaron se në llogaritjen e afateve të vlefshmërisë së kontratës së ngjashme të dorëzuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, në respekt të frymës së ligjit për prokurimin publik merren për bazë afatet kalendarike dhe ajo ato financiare të parashikuar nga legjisllacioni përkatës tatimor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se ankimesi ka paraqitur, krahas kontratës dhe dokumentacionin tjetër shoqërues, edhe faturat tatimore të shitjes të cilat i përkasin viteve 2011,2012,dhe fillimit të vitit 2013 të cilat janë jashtë afatit 3 vjeçar brenda të cilit duhet të dëshmonte operatori ekonomik për kryerjen e punimeve të ngjashme me objektin e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se vlera e realizuar e kontratës për periudhat për të cilat janë paraqitur faturat tatimore nuk mund të merren në konsideratë, pasi për efekt të përlllogaritjes referuar edhe ligjit të prokurimit publik kjo periudhë nuk përfshihet në periudhën tre vjeçare të fundit, nisur nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. _____

Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimes është në kushtet e mospërbushjes së kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me kontratat e ngjashme.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e ankimesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumenta, pasi ankimesi nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për vërtetimin e realizimit të punëve të ngjashme për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes konsiderohet jashtë afatit 3 vjeçar të parashikuar nga neni 27 pika 6 e VKM 914/2014, duke mos përmbushur kriterin e kualifikimit në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF-50272-09-20-2016 me objekt: “*Ndërtimi i catisë të godinës së maternitetit, rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare dhe disa ndërhyrje në Spitalin Kukës*”, me fond limit 6,583,333 lekë pa tvsh e zhvilluar në datën 10.10.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Murati” sh.p.k duke e skualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sark” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.2250 Protokoli, Datë 03.11.2016



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha